



Në mbështetje të nenit 5, paragrafi 1, nënparagrafi 1.1, pika 1.1.1, nenit 12 paragrafi 1, nënparagrafi 1.5 dhe nenit 22, paragrafi 3, të Ligjit Nr.08/L-017 për Agjencinë për Parandalimin e Korrupsionit, nenit 21 paragrafi 2 të Ligjit nr. 06/L-011, për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funkcionit Publik, neni 11, paragrafi 4, i Rregullores Nr. 03/2023 për Procedurat për Hetimet Administrative në Agjencinë për Parandalimin e Korrupsionit, Drejtori i Agjencisë për Parandalimin e Korrupsionit, me datë 23.01.2026, nxjerrë këtë:

V E N D I M

- I. Mbyllet rasti me Nr. të prot. DPKI-MXDOYF-0138, për z. Flamur Hyseni dhe znj. Furtuna Sheremeti, lidhur me pjesëmarrjen në procesin e shqyrtimit disiplinor në cilësinë e kryesuesit dhe të anëtares, në Këshillin e Etikës së Universiteti i Prishtinës “Hasan Prishtina”, sipas denoncimit për shkelje të Kodit të Etikës së Universitetit të Prishtinës, ndaj z. Enver Hasani, Profesor i Universitetit të Prishtinës, për shkak se nuk ka prova të mjaftueshme që argumentojnë dyshimin e arsyeshëm për konflikt interesi në ushtrimin e funksionit publik.
- II. Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit rekomandon Senati e UP-së, që konform nenit 8 paragrafi 3 të LPKI-së, të ndërmarr të gjitha masat e nevojshme për të parandaluar dhe shmangur konfliktin e mundshëm të interesit, në procesin final të kësaj çështje, atëherë kur rekomandimin i Këshillit të Etikës duhet të votohet në Senat.
- III. Ky vendim është përfundimtar në procedurën administrative dhe i njëjti publikohet në uebfaqen zyrtare të Agjencisë për Parandalimin e Korrupsionit.

A r s y e t i m

I. Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit (në vijim: Agjencia), ka pranuar kërkesën Nr.DPKI-MXDOYF-0138, nga z. Enver Hasani, profesor i Fakultetit Juridik të UPHP-së, përmes së cilës ka theksuar se *(citojmë pjesë nga kërkesa e tij): “[...]Aktualisht, Këshilli i Etikës ka filluar një procedurë shqyrtimi ndaj meje, mbi bazën e një kërkesë që, gabimisht, cilësohet si denoncim nga dekani i Fakultetit Juridik. Më datat 23 maj dhe 4 qershor 2025, ju kam informuar për rastin përmes e-maileve përkatëse. Në përbërjen e këtij Këshilli gjenden edhe: znj. Furtuna Sheremeti, asistentë e z. Avni Puka, pra vartëse e drejtpërdrejtë e tij, si në aspektin akademik ashtu edhe në atë administrativ, dhe z. Flamur Hyseni, ligjërues dhe shef i*

Departamentit në Katedrën e të Drejtës Administrative në Fakultetin Juridik, koleg dhe bashkëpunëtor i afërt institucional i dekanit, pra vartës i drejtpërdrejtë institucional në çështjet e avancimit akademik dhe në ato administrative.

Për më tepër, kam iniciuar dy kallëzime penale ndaj dekanit Avni Puka për çështje që lidhen me keqpërdorim të detyrës zyrtare dhe shkelje të integritetit akademik. Rrjedhimisht, përfshirja në proces e dy anëtarëve të afërt me palën inicuese të procedurës përbën një situatë të qartë të konfliktit të interesit, në përputhje me përkufizimet ligjore dhe praktikën vendimmarrëse të Agjencisë suaj, të cilat i paraqesim më poshtë.

Znj. Furtuna Sheremeti aktualisht është asistente në Fakultetin Juridik, në lëndët që i mban z. Avni Puka. Asnjë avancim i saj profesional nuk mund të bëhet pa nënshkrimin e z. Avni Puka, i cili gjithashtu e ka pranuar si asistent në Fakultetin Juridik vite më parë. Znj. Furtuna si asistente, mban të njëjtat lëndë më z. Puka dhe vepron brenda së njëjtës katedër, gjë që krijon një vartësi institucionale të plotë nga ai. Ajo nuk mund të zbatojë planin dhe programin mësimor të orëve të saj pa udhëzime dhe lejen e z. Avni Puka. Të gjitha këto detaje janë të përcaktuara në kontratë e punës së znj. Furtuna Sheremeti dhe përputhen në praktikën e përditshme të asistentëve në Fakultetin Juridik.

Z. Flamur Hyseni, në cilësinë e shefit të Katedrës së të Drejtës Administrative, ka kontakte të përditshme me z. Avni Puka. Asnjë propozim i Katedrës nuk mund të vihet në rend dite pa miratimin e z. Avni Puka, i cili, si dekan i Fakultetit Juridik, kryeson ex officio mbledhjet e Këshillit të Fakultetit. Po ashtu, asnjë avancim profesional apo konkurs për avancim i z. Flamur Hyseni i cili aktualisht mban thirrjen akademike të profesorit asistent dhe ka dy nivele të tjera deri te titulli më i lartë akademik nuk mund të procedohet pa u përfshirë në rend dite nga dekan, z. Avni Puka, në cilësinë e kryesuesit të Këshillit të Fakultetit. Kjo përbën një lidhje të drejtpërdrejtë institucionale, pa llogaritur këtu edhe miqësinë e ngushtë personale ndërmjet z. Hyseni dhe z. Puka, e cila është e njohur gjerësisht”.

Gjithashtu, z. Enver Hasani me datën 10 korrik 2025, ka dërguar edhe një kërkesë në Agjenci përkitazi me rastin konkret, ku theksohet se (citojmë pjesë nga kërkesa e tij): “[..]. Dy anëtarë të Këshillit të Etikës së Fakultetit Juridik, zotëri Flamur Hyseni dhe zonja Furtuna Sheremti, jo vetëm që nuk janë përjashtuar vetë nga shqyrtimi i rastit tim, por as nuk e kanë marrë fare në konsideratë kërkesën time për përjashtimin e tyre ashtu siç e kërkon ligji. Sipas nenin 85, paragrafi 1 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, i cili zbatohet për çdo procedurë administrative, përfshirë edhe ato që zhvillohen pranë APK-së, dy anëtarët e Këshillit të Etikës duhet të kishin pritur vendimin e Agjencisë për Parandalimin e Korrupsionit lidhur me rastin që kam ngritur unë, pasi janë njoftuar me kohë për këtë. Këta dy juristë të Këshillit të Etikës po veprojnë në mënyrë të njëjtë si zoti I.M., pa asnjë lloj skrupulli. Nuk ekziston asnjë procedurë juridike në Evropë, e as në Kosovë, ku dikush kërkon përjashtimin e anëtarit të turpër vendimmarrës (kolektiv apo individual), dhe nuk pezullohet procedura deri të jetë vendosur lidhur me kërkesën e ngritur për përjashtim. Kjo është praktikë e paprecedentë, veçanërisht kur bëhet fjalë për dy juristë të Fakultetit Juridik, profesionistë në fushën e drejtësisë.[...].”

Agjencia konform mandatit dhe kompetencave ligjore që ka, sipas Ligjit Nr.08/L-017 për Agjencinë për Parandalimin e Korrupsionit, ka zhvilluar hetim administrativ, duke trajtuar dhe shqyrtuar pretendimet për konflikt të interesit, në kuptim dhe vështrim të dispozitave të Ligjit

për Parandalimin e Konfliktit të Interesit, përkritazi me pjesëmarrjen në shqyrtimin disiplinor të z. Flamur Hyseni, në cilësinë e kryesuesit dhe znj. Furtuna Sheremeti, në cilësinë e anëtares, në Këshillin e Etikës së UPIIP-së, sipas denoncimit për shkelje të rënda të Kodit të Etikës së UP-së ndaj z. Enver Hasani, profesor në UP-së.

Me qëllim të sqarimit të situatës, Agjencia sipas procedurës së paraparë përmes shkresës zyrtare:DPKI-1371/25, ka kërkuar nga z. Flamur Hyseni informatat dhe dokumentacionin përkatës lidhur me procesin e denoncimit të iniciuar në Këshillin e Etikës të UPHP-së ndaj z. Enver Hasani.

Ku pastaj ka pranuar përmes postes elektronike (e-mailit), nga z. Flamur Hyseni, informatat ku përfshihen përgjigje/sqarime si dhe vendimin mbi emërimin në Këshillin e Etikës së UPHP-së.

Në pajtim me nenin 22, paragrafin 3, dhe 5 të Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit, Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit sipas procedurës përmes shkresës zyrtare (DPKI-1187/25), e ka njoftuar znj. Furtuna Sheremeti, lidhur me fillimin e procedurës për shqyrtimin e gjendjes së konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik.

Po ashtu, në pajtim me nenin 22, paragrafin 3, dhe 5 të Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit, Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit përmes shkresës zyrtare (DPKI-1188/25), e ka njoftuar edhe z. Flamur Hyseni, lidhur me fillimin e procedurës për shqyrtimin e gjendjes së konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik.

Në vazhden e veprimeve procedurale është mbajtur takim me z. Flamur Hyseni, me ç' rast i njëjti është njoftuar me pretendimet e ngritura për konflikt të mundshëm të interesit, si dhe me faktet lidhur me këtë rast. Në takim, z. Hyseni ka paraqitur argumentet dhe qëndrimet e tij lidhur me rastin në fjalë, e gjithashtu të njëjtat më pastaj i ka përcjellur në Agjenci edhe në formë të shkruar.

Nga deklaratat në takim dhe të dërguar përmes e-mailit në Agjenci, z. Flamur Hyseni subjekt i trajtimit për konflikt të interesit, lidhur me çështjen e ngritur për konflikt të interesit ndër të tjera ka deklaruar (*citojmë*):

“Avancimi im i fundit akademik, në thirrjen Profesor Asistent (Prof. Ass.), është realizuar në muajin shkurt të vitit 2020. Në atë periudhë, Prof. Asoc. Avni Puka nuk ka ushtruar funksionin e dekanit të Fakultetit Juridik. Për më tepër, Prof. Puka është i profilizuar në fushën e të drejtës penale, ndërsa unë kam specializim dhe veprimtari të vazhdueshme akademike në fushën e së drejtës kushtetuese dhe administrative, si anëtar i Katedrës Kushtetuese dhe Administrative dhe bartës i lëndës Hyrje në teorinë e shtetit dhe së drejtës. Theksoj se Prof. Asoc. Avni Puka asnjëherë nuk ka qenë pjesë e ndonjë komisioni profesional në proceset e mia të avancimit akademik, as në këtë rast dhe as në nivelet e mëhershme të thirrjeve akademike. Për me tepër, në cilësi të dekanit askush nuk mund të jetë pjesë e komisioneve vlerësuese që propozon zgjedhjen apo avancimin e personelit akademik.

Që nga fillimi i muajit maj 2025, nuk e ushtroj funksionin e shefit të Katedrës të së Drejtës Kushtetuese dhe Administrative. Rrjedhimisht, në kohën e shqyrtimit të rastit konkret në Këshillin e Etikës dhe përgjatë tërë periudhës relevante për këtë çështje, nuk kam pasur asnjë funksion drejtues në nivel katedre.

Raportet e mia me dekanin, Prof. Asoc. Avni Puka, janë të natyrës zyrtare dhe institucionale, në kuadër të marrëdhënieve të zakonshme brenda Fakultetit Juridik. Secili anëtar i stafit akademik, përfshirë edhe dekanin, ushtron detyrat dhe përgjegjësitë sipas autonomisë institucionale akademike dhe akteve normative të Universitetit të Prishtinës. Marrëdhëniet ndërmjet kolegëve në këtë kontekst nuk përbëjnë rrethana të veçanta që do të mund të prodhonin konflikt interesi, aq më tepër kur vendimmarrja në Këshillin e Etikës është kolegjiale, e mbështetur në procedura dhe standarde të parapërcaktuara me rregullore. Për dallim edhe nga institucionet e tjera publike, për shkak të natyrës së punë në universitet, personeli akademik gëzon një autonomi me të gjerë. Është më rëndësi të sqarohet edhe fakti se në cilësi të Kryetarit të Këshillit të Etikës, dhe si anëtar i këtij organi kolegjial në nivel të universitetit, nuk jam i propozuar nga dekani apo fakulteti, por emërimi është bërë nga universiteti, senati, në bazë të shprehjes së interesit, bazuar në thirrjen nga Rektorati për gjithë personelin akademik të UP-së”.

Gjithashtu, si palë në procedurë është mbajtur takim edhe me znj. Furtuna Sheremeti, me ç’rast e njëjta është njoftuar me pretendimet e ngritura për konflikt të mundshëm të interesit, si dhe faktet lidhur me këtë rast. Në takim, znj. Sheremeti ka paraqitur argumentet dhe qëndrimet e saj lidhur me rastin në fjalë, e gjithashtu të njëjtat i ka përcjellë në Agjenci edhe në formë të shkruar.

Nga deklaratat (përgjigjet) në takim dhe ato të dërguar përmes e-mailit në Agjenci nga znj. Furtuna Sheremeti, subjekt i trajtimit për konflikt të mundshëm të interesit, theksohet se (citojmë pjesë nga deklarata): “z. Hasani pretendon: Znj.Furtuna Sheremeti aktualisht është asistente në Fakultetin Juridik, në lëndët që i mban z. Avni Puka. Asnjë avancim i saj profesional nuk mund të bëhet pa nënshkrimin e z. Avni Puka (...) mban të njëjtat lëndë më z. Puka dhe vepron brenda së njëjtës katedër (...). Ajo nuk mund të zbatojë planin dhe programin mësimor të orëve të saj pa udhëzime dhe lejen e z. Avni Puka (...)”.

Me tutje, znj. Sheremeti vazhdon: “Këto pohime janë të pavërteta dhe mund të rrëzohen lehtësisht. Më poshtë po paraqes sqarimet e mia për secilën prej tyre: Kontrata ime është lidhur me Universitetin, jo me Fakultetin. Në kohën e pranimit tim, konkursi ka qenë i hapur dhe zgjedhja ime është bërë nga Senati i Universitetit, në kohën kur dekan ishte z. Haxhi Gashi. Dokumentet përkatëse e konfirmojnë këtë. Në Fakultetin Juridik nuk ekziston “asistenti personal” i një profesori. Asistentët caktohen nga katedrat, jo nga individët. Unë jam asistente pranë Katedrës së Drejtës Penale, ky është një fakt i thjeshtë dhe i verifikueshëm.

Që nga viti 2019, kur kam filluar punën, nuk kam mbajtur asnjë lëndë të z. Avni Puka. Kam ushtruar detyra mësimore në lëndët:

- Kriminalistikë (bartës i lendes: Haki Demolli)
- E Drejta e Procedurës Penale (bartës i lendes: Azem Hajdari)
- E Drejta e Procedurës Penale pjesa e posaçme (bartës i lendes: Azem Hajdari)
- Terrorizëm (bartës i lendes: Haki Demolli)
- Viktimologji (bartës i lendes: Rexhep Gashi)
- Kriminologji dhe Penologji (bartës i lendes: Rexhepi Gashi)
- Drejtësia Tranzicionale (bartës i lendes: Remzije Istrefi)

Asnjëra prej këtyre nuk është lëndë e z. Avni Puka, prandaj pretendimi se mbaj "të njëjtat lëndë" me të nuk qëndron. Për më tepër, të gjitha këto fakte mund të verifikohen përmes sistemit elektronik SEMS, ku përcaktohen asistentët për çdo lëndë, si dhe nga oraret zyrtare të ushtrimeve dhe ligjëratave të publikuara në faqen zyrtare dhe të shpërndara tek i gjithë personeli dhe studentët në fillim të çdo semestri. Përveç kësaj, dokumentet zyrtare që pasqyrojnë ngarkesën dhe angazhimin e personelit akademik të Fakultetit Juridik ofrojnë prova shtesë. Të gjitha këto dokumente, si dhe çdo material tjetër relevant, mund të sigurohen zyrtarisht nga institucioni - Fakulteti Juridik i UP-së.

Zbatimi i planeve dhe programeve mësimore: Syllabuset e lëndëve ku jap mësim përcaktohen nga profesorët bartës të tyre: prof. Azem Hajdari, prof. Haki Demolli dhe prof. Rexhepi Gashi. Nuk kam kërkuar asnjëherë udhëzime nga Dekani për këtë, sepse nuk ka asnjë arsye të tillë.

Procesi i avancimit profesional: Rregulloret e Universitetit e përcaktojnë qartë se procedurat e avancimit nuk varen nga një person i vetëm. Për më tepër, pranimi im në punë është bërë në kohën kur z. Avni Puka nuk ka qenë dekan, gjë që e përgënjeshton pretendimin se karriera ime varet nga ai.

Çështja e "konfliktit të interesit": Supozimi se dy kolegë në të njëjtin Fakultet nuk mund të marrin pjesë në vendimmarrje për shkak të një konflikti të supozuar interesi është i pabazuar dhe i rrezikshëm. Nëse do zbatohet kjo logjikë, nuk do të funksiononte asnjë organ, përfshirë Këshillin e Etikës, pasi të gjithë jemi kolegë brenda të njëjtit institucion".

Më pas, Agjencia përmes shkresës zyrtare (DPKI-1651/25), ka kërkuar nga Universiteti i Prishtinës informatat dhe dokumentacionin lidhur me denoncimin ndaj z. Enver Hasani të iniciuar në Këshillin e Etikës të UPHP-së. UPHP duke u përgjigjur në kërkesën si më lartë, ka dërguar në Agjenci dokumentacionin relevant (e-maili i datës 15.09.2025).

Pas administrimit të provave relevante që lidhen me vërtetimin e pretendimeve për konflikt të interesit, përfshirë informatat e pranuar nga raportuesi i rastit, deklaratat dhe sqarimet e dhëna nga z. Flamur Hyseni dhe znj. Fortuna Sheremeti, në takimet e mbajtura, si dhe informacionin e siguruar sipas detyrës zyrtare, është vlerësuar gjendja faktike si në vijim:

Me Vendimin nr. prot. 5/596, datë 09.12.2024, të Senatit të UPHP-së, z. Flamur Hyseni dhe znj. Fortuna Sheremeti janë emëruar anëtarë të Këshillit të Etikës së Universitetit të Prishtinës;

Më datë 16.05.2025, Dekani i Fakultetit Juridik të UPHP-së, Prof.asoc. Avni Puka, ka paraqitur kërkesën (Nr.01/1/781), për shqyrtim të denoncimit ndaj z. Enver Hasani të datës 26.08.2024 ("Denoncim për shkeqej të rënda të Kodit të Etikës të Universitetit të Prishtinës dhe obligimeve akademike nga z. Enver Hasani, bazuar në Raportin e monitorimit nga Agjencia e Kosovës për Akreditim (AKA), si dhe fakteve dhe provave tjera relevante), duke u bazuar në Opinion e Agjencisë për Parandalimin e Korrupsionit (Reference: APK-DPKI-1270/24, datë 17.12.2024)

Më datë 23.05.2025, Këshilli i Etikës i Universitetit të Prishtinës, përmes e-mailit, ka njoftuar z. Enver Hasani, që në pajtim me dispozitat procedurale për trajtimin e rasteve, në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh të paraqes deklarinimin e tij lidhur me denoncimin e bërë nga Dekani i Fakultetit Juridik;

Me datën 23.05.2025, z. Enver Hasani i ka dërguar e-mail Këshillit të Etikës, ku përveç të tjerash thekson se, *anëtarët e Këshillit të Etikës që janë nga Fakulteti Juridik kanë konflikt interesi në çdo shqyrtim të denoncimit që vjen nga mbikëqyrësi i tyre i parë z. Avni Puka;*

Sipas ekstraktit të procesverbalit të mbledhjes së Këshillit të Etikës, të mbajtur më datë 10.07.2025, z. Flamur Hyseni, gjatë mbledhjes, ka deklaruar se: *“Ne i kemi jep të drejtën e deklarimit të denoncuarit dhe ai nuk ka ofruar asnjë provë rreth kësaj madje e ka zhvendosur dikund tjetër kontekstin e çështjes dhe madje na ka vënë kushte neve. Ne duhet të vendosim konform nenit 8 paragrafi 4 dhe mos të shkojmë kumulative por ti propozojmë Senatit vetëm 1 masë sipas Ligjit të Procedurës së Përgjithshme Administrative e pastaj Senati merr vendim ndërsa ndaj vendimeve të Senatit është kompetent Këshilli Drejtues. Edhe nëse i referohemi Ligjit për Procedurën Administrative me nr. 05/L-031, përkatësisht nenit 87 të këtij ligji, pala detyrohet që të sjellë prova, informata, të japë një deklaratë me shkrim dhe jo të paraqesë kushte për organin sikurse ka vepruar pala e denoncuar në raport me Këshillin e Etikës duke na vënë kushte e duke mos e respektuar Ligjin dhe procedurën. Pala e denoncuar ka pasur afat dhe mundësi të jap deklaratë me shkrim ose verbale. Sipas Ligjit të Procedurës së Përgjithshme Administrative, nëse nuk gabohem nenit 88 dhe 89 të këtij ligji thuhet që faktet që janë të njohura për organin publik nuk kanë nevojë të provohen për këtë arsye edhe procedura e mëhershme provuese vlen sepse nuk ka asnjë ndryshim të gjendjes faktike”;*

Sipas procesverbalit të datës 10.07.2025, në mbledhjen e Këshillit të Etikes, ku të pranishëm ishin 5 anëtarë, me 3 vota për, 1 vota kundër u vendosë shqiptimi i masave: 1. *Mohim i përfshirjes nëpër komisione nëpër të gjitha nivelet* dhe 2.1.2. *Vërejtje me shkrim*, ndërsa këto masa do të ekzekutohen nga fakulteti përkatës, ndaj z. Enver Hasani. Në këtë votim nuk mori pjesë anëtari, z. Safet Merovci, pasi i njëjti deklaroi konflikt të interesit.

Megjithatë, me datë 14.07.2025, Këshilli i Etikës merr vendimin nr. prot.1/724, me të cilin shqipton dy (2) masa ndaj z. Enver Hasani, duke theksuar se këto masa do të hyjnë në fuqi pas miratimit nga Senati i Universitetit të Prishtinës dhe pranimi të vendimit nga Rektori;

Më pas me datë 05.06.2025, z. Enver Hasani i drejtohet Agjencisë me kërkesën e sipërcituar për shqyrtimin e gjendjes së mundshëm të konfliktit të interesit të anëtarëve të Këshillit të Etikës nga Fakulteti Juridik i UPHP-së;

Me datë 29.09.2022, me Vendimin Nr. 3/245, të Rektorit të Universitetit të Prishtinës, znj. Furtuna Sheremeti është riemëruar në thirrjen akademike Asistent për grup lëndësh në Katedrën Penale (O) të Fakultetit Juridik

Më datë 27.02.2020, me Vendimin Nr. prot. 500, të Rektorit të Universitetit të Prishtinës, z. Flamur Hyseni zgjedhet në thirrjen akademike Profesor Asistent për lëndët: Fillet e së drejtës (O), Retorika dhe shprehjet juridike (Z), Metodologjia e së drejtës hulumtuese (O), në Fakultetin Juridik, për periudhë 4 vjeçare;

Sipas Ekstraktit të procesverbalit të mbledhjes së Katedrës Kushtetuese–Administrative, Nr.09/67, të datës 06.05.2025, Flamur Hyseni lirohet nga detyra e shefit të katedrës, meqenëse i njëjti është zgjedhur nga Senati i UPIIP-së anëtar në Këshillin e Etikës, ndërsa sipas vendimit Nr.09/74 të datës 14.05.2025 në vend të z. Flamur Hyseni është emëruar Prof. Ass. Islam Pepaj.

Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit, pas zhvillimit të procedurës dhe administrimit të provave relevante konstaton se: pjesëmarrja e z. Flamur Hyseni në cilësinë e kryesuesit dhe znj. Furtuna Sheremeti në cilësinë e anëtares, në Këshillin e Etikes së UPIIP-së, në procedurën e shqyrtimit disiplinor në cilësinë e kryesuesit dhe të anëtares lidhur me denoncimin ndaj z. Enver Hasani, nuk bie ndesh me dispozitat e Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit.

Neni 6, i Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit, ka përkufizuar nocionin e konfliktit të interesit, si vijon:

"Konflikti i interesit lind nga një rrethanë në të cilën zyrtari ka interes privat, që ndikon, mund të ndikojë ose duket se ndikon në kryerjen me paanshmëri dhe objektivitet të detyrës së tij zyrtare".

Po ashtu, me nenin 3 [Përkufizimet], paragrafi 1, nën paragrafi 1.2 të Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit, është përkufizuar se:

"Interesi privat i personit zyrtar - nënkupton çfarëdo përparësie për personin zyrtar, familjen e tij, të afërmit, miqtë dhe personat apo organizatat me të cilat ai ka pasur apo ka marrëdhënie afariste",

Nën paragrafin 1.6 të këtij neni me të cilin është përkufizuar se:

"person i afërm me zyrtarin është bashkëshorti ose personi që bashkëjeton, të afërmit në vijë të drejtë të gjakut pa kufizime, të afërmit në vijë të tërthortë deri në shkallën e katërt, adoptuesi, i adoptuari, i afërmi në gjini të krushqisë deri në shkallën e dytë si dhe çdo person fizik apo juridik i cili ka pasur ose ka një lidhje të përbashkët interesi privat pasuror ose jopasuror me zyrtarin. Për qëllime të këtij ligji, personi juridik konsiderohet si person i afërm, sipas dispozitave të Kodit Penal të Republikës së Kosovës".

Ndërsa, nën paragrafi 1.12 i këtij neni përcakton vendimmarrjen si:

"çasti i fundit i procesit vendimmarrës gjatë të cilit vendoset përmbajtja përfundimtare e aktit apo kontratës si dhe ato çaste paraprake të vendimmarrjes të cilat janë thelbësore dhe përcaktuese në të cilat pjesëmarrja, ndikimi dhe qëndrimi i zyrtarit përcaktojnë përmbajtjen përfundimtare të aktit apo kontratës si dhe çdo veprim i zyrtarit në ushtrimin e funksionit publik."

Pra, në kuptim të dispozitave të sipërcituara, konflikti i interesit është i lidhur ngushtë me procesin e vendimmarrjes, nën kushtet e ekzistencës së interesit privat të zyrtarit/ve apo të personave të afërm me ta, në një çështje të caktuar.

Kësisoj, në rastin konkret, Agjencia ka konstatuar se pjesëmarrja e z. Flamur Hyseni dhe znj. Furtuna Sheremeti në cilësinë e anëtarëve në Këshillin e Etikës së UPHP-së, në procedurë lidhur me denoncimin ndaj z. Enver Hasani, nuk bie ndesh me dispozitat e Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit, pasi që nuk është vërtetuar se të njëjtit kanë (pasur) interes privat në procesin e shqyrtimit disiplinor, në kuptim të dispozitave të Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit.

Sikurse është shtjelluar më sipër, pretendimet e ngritura për konflikt të interesit ndaj z. Flamur Hyseni, përkritazi me cilësinë e tij si shef i Katedrës së të Drejtës Administrative dhe raportet personale të tij me dekanin e Fakultetit Juridik, nga administrimi i provave relevante, rezultojnë të jetë raport profesional, ose raport zyrtar brenda institucionit, e jo "person i afërt" sipas përkufizimit ligjor.

Njësoj, sikur edhe pretendimet e ngritura për konflikt të interesit ndaj znj. Fortuna Sheremeti se e njëjta është asistente në lëndët që i mban dekanin aktual i Fakultetit Juridik, i cili e ka pranuar si asistente në Fakultetin Juridik dhe se e njëjta nuk mund të zbatohet planin dhe programin mësimor të orëve të saj pa udhëzime dhe lejen e dekanit në fjalë, rezultojnë të jenë

raporte profesionale, ose raporte zyrtar brenda institucionit, e jo "person i afërt" sipas përkufizimit ligjor.

Gjithashtu, fakti që z. Flamur Hyseni dhe znj. Furtuna Sheremeti, sikurse edhe gjithë bashkë-kolegët e tyre i raportojë drejtpërdrejt Dekanit të Fakultetit Juridik, kjo nuk i bënë ata "*persona të afërm*" në kuptim të dispozitave të Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit, pasi që raportet profesionale (akademike) dhe ato administrative në funksion të përmbushjes së detyrave dhe përgjegjësisë të punës, në rastin konkret në procedurë lidhur me denoncimin, nuk e bëjnë Dekanin e Fakultetit Juridik "*person të afërt*" me dy anëtarët e Këshillit të Etikës z. Flamur Hyseni dhe znj. Furtuna Sheremeti, gjithnjë sipas dispozitave të Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit.

Për më tepër, raporti hierarkik (akademik dhe/ose administrativ) i anëtarëve të Këshillit të Etikës me dekanin e Fakultetit Juridik, nuk ka qenë kontestues e as pretendim ankimor për konflikt të interesit as në përbërjen e mëhershme të Këshillit të Etikës.

Prandaj, duke qenë se në situatën konkrete, nuk është konstatuar ekzistenca e *interesit privat të zyrtarëve apo i personave të afërm¹ me zyrtarët*, dhe kështu nuk është përmbushur njëri nga kushtet thelbësore (kumulative) të konfliktit të interesit, atëherë në këtë rast, përjashtohet konflikti i interesit sipas dispozitave të Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit.

Gjithsesi, fakti që, në situatën konkrete të referuar në Agjencinë, nuk është konstatuar ekzistenca e *interesit privat të zyrtarëve ose i personave të afërm me zyrtarin*, dhe rrjedhimisht është përjashtuar konflikti i interesit në vështrim dhe kuptim të dispozitave të Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit, kjo nuk do të thotë se Këshilli i Etikës nuk ka (pasur) obligim ta trajtojë kërkesën e z. Enver Hasani për përjashtim të zyrtarit/ve (dy anëtarëve të sipërpërmendur të Këshillit të Etikës) nga procedura administrative, sipas rregullativës së brendshme të UPHP-së dhe/ose legjislacionit tjetër relevant, veçanërisht Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative (në vijim: LPPA).

Kjo edhe në linjë me nenin 20, paragrafi 3 të Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit, ku është përcaktuar se: "***Institucionet në kuadër të akteve të tyre të brendshme, parashohin dhe zbatojnë rregulla të veçanta për parandalimin e konfliktit të interesit, varësisht fushëveprimt të institucionit përkatës***". Në këtë kontekst, pavarësisht faktit se kjo situatë (sikur u shtjellua më sipër) nuk përbën konflikt të interesit sipas dispozitave të Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit, situata e parashtruar më sipër, megjithatë, mund të jetë rrethanë për përjashtimin e zyrtarit/ve nga një çështje administrative konform dispozitave përkatëse të LPPA-së, marrë parasysh faktin se dispozitat e nenit 29 të LPPA-së, çështjen e përjashtimit të zyrtarit, veçanërisht kur behet fjale për *paanshmërinë* e kundron më gjerësisht dhe jo domosdoshmërisht të lidhur me ekzistencën e *interesit privat* (si kusht kumulativ) siç është rasti me nocionin e konfliktit të interesit sipas Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrim të Funkcionit Publik.

Në këtë kontekst duke marrë parasysh edhe qëndrimin e njërit prej anëtarëve të Këshillit të Etikës i cili ka deklaruar se: "*Konsideroj se është komprometuar plotësisht puna jonë si Këshill i Etikës në lidhje e me këtë rast. As tërheqja eventuale e kryesuesit nuk e shpëton Këshillin nga*

¹ Në rastin konkret nuk është konstatuar të ketë pasur "*persona të afërm*", në kuptim të dispozitave të Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit.

dështimi në përgjegjësinë që e kemi që të jemi të paanshëm”, e bëjnë të domosdoshme trajtimin e kësaj çështje paraprake nga Këshilli i Etikës.

II. Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit, konform edhe rekomandimeve të saja të më hershme, rekomandon sërish Senatin e UP-së, që në pajtim me nenin 8, paragrafi 3, të LPKI-së; “të ndër marr të gjitha masat e nevojshme për të parandaluar dhe zgjidhur rastet e konfliktit të interesit” në procesin final të kësaj çështje, në kohën kur rekomandimi i Këshillit të Etikës duhet të shqyrtohet/votohet në Senat.

III. Agjencia vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi, duke u bazuar në nenin 22 [Procedura administrative e Agjencisë për rastet e konfliktit të interesit], paragrafi 12 të Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit, me të cilin është përcaktuar se: “Të gjitha vendimet që i nxjerr Agjencia lidhur me konfliktin e interesit në ushtrimin e funksionit publik dhe shkeljen e dispozitave të këtij ligji, përfshirë veprimet e ndaluara ose të kufizuara në ushtrimin e funksionit publik, ushtrimin e veprimtarive të tjera, papajtueshmëritë në ushtrimin e funksionit publik, duhet të respektohen nga zyrtarët dhe institucionet përgjegjëse. Ato bëhen publike në faqen zyrtare të internetit të Agjencisë”, si dhe paragrafin 15 të këtij neni, me të cilin është përcaktuar se: “Vendimet e Agjencisë në lidhje me konfliktin e interesit janë përfundimtare në procedurë administrative.”.

Prandaj, nga sa u tha më lartë, u vendos si në dispozitave të këtij vendimi.

KËSHILLA JURIDIKE: Palët e pakënaqura kanë të drejtë të inicioj konflikt administrativ në Gjykatën Themelore të Prishtinës, Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit ligjor prej tridhjetë (30) ditësh, nga data e pranimit të këtij vendimi.

Vendimi iu dërgohet:


MIL BULESHKAJ
Direktor i Agjencisë për
Parandalimin e Korrupsionit

- Zyrtarëve publikë të përfshirë në rast
- Organit/institucionit udhëheqës (KD, Rektorit të UP-se, Senatit)
- Palës denoncuese